

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2026

Nr. Rendor (1)	Data e kërkesës (2)	Objekti i kërkesës (3)	Data e përgjigjes (4)	Përgjigje (5)	Mënyra e përfundimit të kërkesës (6)	Tarifa (7)
1	05.01.2026	Aktet (draft apo të miratuara) mbi lehtësitë fiskale për gazetari investigative.	15.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se Administrata Tatimore është një organ ligjzbatues dhe jo politikbërës. Lutemi për trajtimin e kërkesës suaj t'i drejtoheni institucioneve kompetente.	E plotë	Nuk ka
2	19.01.2026	Sa call center operojnë aktualisht të regjistruar në Shqipëri? Sa punonjës janë të regjistruar aktualisht? Sa kontrole janë kryer gjatë 3 viteve të fundit?	30.01.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Administrata Tatimore nuk disponon statistika sipas formatit të kërkuar. Lidhur me të dhënat e kërkuara, sqarojmë se, objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB jo gjithmonë është i kufizuar në një aktivitet të vetëm. Në rastet kur një subjekt, në momentin e regjistrimit, ku ka deklaruar një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike, pa evidentuar një aktivitet të veçantë apo kryesor, nuk është e mundur të identifikohet në mënyrë të veçantë aktiviteti kryesor i subjektit, përse kohë nuk ka një deklaram nga tatimpaguesi se kush është aktiviteti kryesor që ai kryen.	E plotë	Nuk ka

3	30.01.2026	Informacion nëse ka ndonjë ligj apo udhëzim i cili fal gjobat apo kamatvonesat të cilat janë për shkak të plotësimit me vonesë të DIVA-s.	05.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, Administrata Tatimore ju informon se institucionet kompetente do të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, 'Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore, si dhe të detyrimeve të pagueshme në doganë'. Në këto akte do të parashikohet edhe procedura përkatëse për zbatimin e këtij ligji, e cila, në vijim do t'ju bëhet me dije të gjithë tatimpaguesve.	E plotë	Nuk ka
4	05.02.2026	Sa është numri i tatimpaguesve të regjistruar në fushën e mediave audiovizive, sa gazetarë janë të punësuar?	19.02.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Tatimpagues të pajisur me nipt të cilët ushtrojnë aktivitet në fushën e Mediave audiovizive, të shkruar dhe elektronike janë 1,219 subjekte. Gjatë vitit 2025 gazetar të punësuar në total janë 1,201. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se: Kjo kategori tatimpaguesish gazetarë/punonjës të medias regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe Kodi NACE-2 bëhet me vetëdeklarim nga ana e tyre. Të dhënat e regjistrimit, konkretisht Klasa 4 shifrore, transmetohen nga QKB dhe Administrata Tatimore është përfitues i të dhënave. Administrata Tatimore më pas, administron të dhënat e dërguara për tatimpaguesit, me ndarje të llojit të	E plotë	Nuk ka

				<p>veprimtarive ekonomike sipas klasave të parashikuara në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2.</p> <p>Lutemi gjeni bashkëlidhur Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, (e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare të INSTAT), përmes së cilës mund të përcaktohet lloji i aktivitetit dhe kodi NVE Rev 2, për të cilën jeni i interesuar, në mënyrë të tillë që t'ju vendosim në dispozicion një informacion më të plotë.</p>		
5	16.02.2026	Sa individë janë të regjistruar si influencer? Sa para janë gjeneruar nga individë nëpërmjet platformave digjitale?	10.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjmë me dije se, Administrata Tatimore nuk disponon statistika sipas formatit të kërkuar, për arsye se:</p> <p>Kategoria e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitet si “influencer” regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku kodi NACE Rev.2 deklarohet me vetëdeklarim nga ana e subjektit. Sqarojmë se objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB-së nuk është domosdoshmërisht i kufizuar në një aktivitet të vetëm, pasi në momentin e regjistrimit subjektet mund të deklarojnë një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike. Të dhënat e regjistrimit (Klasa 4-shifrore sipas NACE Rev.2) transmetohen nga QKB tek Administrata Tatimore, e cila është përfituese e këtyre të dhënave dhe i administron ato sipas klasifikimit të</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>përcaktuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2). Megjithatë, nuk ekziston një klasifikim i veçantë specifik për aktivitetin “influencer”, ndaj gjenerimi i statistikave të sakta në këtë rast është i pamundur.</p> <p>Sa i përket të ardhurave të gjeneruara nga platformat digjitale, Administrata Tatimore është duke punuar për regjistrimin e këtyre platformave në Shqipëri, me qëllim evidentimin dhe monitorimin e të ardhurave që realizohen përmes tyre.</p> <p>Informacion shtesë mund të merret edhe pranë institucioneve bankare, sipas kërkesës, pasi edhe Administrata Tatimore, në raste të caktuara dhe në kuadër të planeve të saj, kërkon të dhëna pranë bankave.</p>		
6	17.02.2026	Si plotësohet deklarata e DIVA 2025? A ka ndonjë video ilustruese?	18.02.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se:</p> <p>Për mënyrën e plotësimit të kësaj deklarate ka të publikuar video në faqen zyrtare të tatimeve si dhe në rrjetet sociale, ku jepen udhëzime dhe instruksione hap pas hapi mbi mënyrën e plotësimit të deklaratës DVAP. Video udhëzuesin mund ta ndiqni këtu:</p> <p>https://youtu.be/xmUqnbudbEk?si=eFE4mqRxiDILhOp3</p>	E plotë	Nuk ka

7	20.02.2026	Numri total i subjekteve ekonomike që zhvillojnë aktivitet në hoteleri 'akomodim' dhe shpërndarja sipas qyteteve dhe numri total i të punësuarëve	04.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se: Administrata Tatimore përpunoi informacionin duke identifikuar tatimpaguesit aktivë që kanë përshkrim aktiviteti "akomodim",</p> <table border="1" data-bbox="1142 412 1659 695"> <thead> <tr> <th>DRT</th> <th>Nri NIPT-ve</th> <th>Nr mesatar punonjeshish 2025</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat</td><td>94</td><td>281</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër</td><td>64</td><td>181</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM</td><td>18</td><td>2,325</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës</td><td>394</td><td>2,704</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan</td><td>85</td><td>318</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier</td><td>54</td><td>216</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë</td><td>127</td><td>347</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë</td><td>175</td><td>769</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës</td><td>99</td><td>100</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë</td><td>142</td><td>552</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë</td><td>665</td><td>1,772</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër</td><td>303</td><td>1,112</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë</td><td>615</td><td>3,468</td></tr> <tr><td>Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë</td><td>437</td><td>1,663</td></tr> <tr><td>Total</td><td>3,212</td><td>15,808</td></tr> </tbody> </table>	DRT	Nri NIPT-ve	Nr mesatar punonjeshish 2025	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	94	281	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	64	181	Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	18	2,325	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	394	2,704	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	85	318	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	54	216	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	127	347	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	175	769	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	99	100	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	142	552	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	665	1,772	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	303	1,112	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	615	3,468	Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	437	1,663	Total	3,212	15,808	E plotë	Nuk ka
DRT	Nri NIPT-ve	Nr mesatar punonjeshish 2025																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat	94	281																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër	64	181																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM	18	2,325																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës	394	2,704																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan	85	318																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier	54	216																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë	127	347																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Korçë	175	769																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës	99	100																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë	142	552																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Sarandë	665	1,772																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër	303	1,112																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë	615	3,468																																																				
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë	437	1,663																																																				
Total	3,212	15,808																																																				
8	25.02.2026	A ka deleguar firmën drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ilir Binaj tek nëpunësit në mungesë të tij në datat 19.02.2026-25.02.2026	10.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Bazuar në parashikimet konkrete të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" (nenet 11 e vijues), "Kodit të Procedurave Administrative" (neni 34), dhe tërësisë së akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e administratës publike, në të gjitha rastet e mungesës, të pamundësisë apo të paaftësisë afatshkurtër për të vepruar, kryerja e detyrave të titullarit apo çdo drejtuesi të Administratës Tatimore është bërë nga personi zëvendësues i caktuar sipas ligjit. Në këtë kuptim, Administrata Tatimore konfirmon ekzistencën e urdhrin për delegimin e kompetencave, të lëshuar nga nëpunësi z. Ilir Binaj, për periudhën</p>	E plotë	Nuk ka																																																

				19.02.2026 deri më 25.02.2026, për arsye familjare dhe shëndetësore.		
9	27.02.2026	Sa subjekte me aktivitet fasoneria janë të regjistruara në QKB, sa është numri i të punësuarëve, sa janë me status aktiv dhe pasiv?	06.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, Administrata Tatimore ju bën me dije se:</p> <p>Në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2 nuk ka një përcaktim të tillë, tatimpagues të regjistruar me emërtimin ‘fasoneri’. Sqarojmë se Administrata Tatimore administron të dhëna lidhur me këta tatimpagues vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike NVE Rev 2 dhe jo sipas përcaktimit të cituar nga kërkuesi.</p> <p>Në përmbushje të misionit dhe detyrimeve të saj për transparencë, Administrata Tatimore publikon informacion përmes raporteve vjetore, të cilat janë të disponueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit.</p>	E plotë	Nuk ka
10	18.03.2026	Sa kontrole tatimore janë kryer në sektorin e basteve dhe lojërave të fatit për 2 vitet e fundit?	25.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Administrata Tatimore nuk disponon statistika të gjeneruara sipas formatit të kërkuar nga ana juaj.</p> <p>Në përmbushje të misionit dhe detyrimeve të saj për transparencë, Administrata Tatimore publikon informacion përmes raporteve vjetore, të cilat janë të</p>	E plotë	Nuk ka

				disponueshme dhe të aksesueshme për publikun në faqen zyrtare të institucionit (https://www.tatime.gov.al/)		
11	18.03.2026	Kërkojmë një vërtetim për pagim detyrimesh të organizatës jofitimprurëse “X”	26.03.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se shërbimi “Vërtetim për pagim detyrimesh” ofrohet online në portalin e-Albania. Mund t’a aksesoni përmes linkut të mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11169	E plotë	Nuk ka
12	08.04.2026	Informacion nëse marrëveshja “Për shmangien e taksimit të dyfishtë” nënshkruar me Sllovakinë, ka hyrë në fuqi apo jo? Nëse po, në çfarë datë?	08.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi në linkun bashkëlidhur gjeni informacionin e kërkuar https://www.tatime.gov.al/c/6/125/marreveshje-nderkombetare	E plotë	Nuk ka
13	14.04.2026	Informacion lidhur me detyrimin për pajisje me POS për pranimin e pagesave pa para në dorë (non-cash).	22.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar pikës 3, të nenit 59/3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, e shtuar me ligjin nr. 79/2025, është parashikuar shprehimisht: 3. Terminali “POS/POI” është pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave bankare apo të instrumenteve të tjera të pagesave elektronike në pikën e shitjes ose të ndërveprimit. Informacioni për pagesën	E plotë	Nuk ka

				<p>merret nëpërmjet faturave letër nga терминаlet mekanike ose elektronike.</p> <p>Gjithashtu, referuar edhe relacionit që ka shoqëruar ndryshimin ligjor, ky ndryshim ligjor vjen në kuadër të politikave për reduktimin e përdorimit të parasë në dorë, nxitjen e pagesave elektronike dhe garantimin e shërbimit për vizitorët e huaj që preferojnë të paguajnë me karta bankare debiti/krediti.</p> <p>Pra, qëllimi i dispozitës dhe i ligjit është nxitja e tatimpaguesve të pajisen me terminale të certifikuara që lehtësojnë kryerjen e transaksioneve elektronike duke rritur transparencën dhe ulur varësinë nga pagesat me para në dorë.</p> <p>Për këtë qëllim, përdorimi i aplikacioneve telefonike për pranimin e pagesave nga ana e subjekteve tatimpagues është një mekanizëm ligjor dhe i pranuar, por përdorimi i aplikacioneve telefonike nuk përjashton tatimpaguesin nga detyrimi ligjor që të disponojë në ambiente të ushtrimit të aktivitetit edhe terminale për pranimin e pagesave me kartë bankare debiti/krediti.</p>		
14	28.04.2026	Informacion nëse subjekti 'X' është i regjistruar në organet tatimore, është i pajisur me nipt, sa punonjës ka të deklaruar?	11.05.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Bizneset në Republikën e Shqipërisë regjistrohen fillimisht pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), i cili është institucioni përgjegjës për kryerjen e regjistrimit fillestar të subjekteve tregtare</p>	E plotë	Nuk ka

				<p>dhe pajisjen e tyre me Numrin e Identifikimit për Personin e Tatuashëm (NIPT). Pas përfundimit të regjistrimit, të dhënat përkatëse të subjektit transmetohen në mënyrë automatike dhe elektronike tek Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), për qëllime të regjistrimit fiskal dhe administrimit të detyrimeve tatimore, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.</p> <p>Sa më sipër, në faqen zyrtare të QKB publikohet informacioni bazë për të gjithë subjektet e regjistruara dhe të pajisura me NIPT, i cili është i aksesueshëm për të gjithë në adresën zyrtare www.qkb.gov.al.</p> <p>Çdo informacion që nuk është i publikuar në QKB, konsiderohet konfidencial dhe si i tillë trajtohet nga Administrata Tatimore, në përputhje me nenet 24, 25 dhe 31 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>		
15	29.04.2026	Sa është numri total i personave të punësuar si gazetar dhe punonjës të mediave nga viti 2016 deri në vitin 2026 në Republikën e Shqipërisë.	14.05.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë si më poshtë vijon:</p> <p>Kategoria e tatimpaguesve që ushtrojnë aktivitetet regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku kodi NACE Rev.2 deklarohet me vetëdeklarim nga ana e subjektit. Sqarojmë se objekti i veprimtarisë së subjekteve të regjistruara pranë QKB-së nuk është</p>	E plotë	Nuk ka

domosdoshmërisht i kufizuar në një aktivitet të vetëm, pasi në momentin e regjistrimit subjektet mund të deklarojnë një gamë të gjerë aktivitetesh ekonomike. Sa më sipër, në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2 nuk ka një përcaktim të tillë, tatimpagues të regjistruar si punonjës të medias. Sqarojmë se Administrata Tatimore administron të dhëna lidhur me këta tatimpagues vetëm sipas llojit të veprimtarive të parashikuara nga Nomenklatura e Kodeve Ekonomike NVE Rev.2 dhe jo sipas përcaktimit të cituar nga kërkuesi.

Përsa i përket numrit të të punësuarëve në fushën mediatike, e cila përfshin kategori të ndryshme si televizioni, media e shkruar, radio etj, gjeni informacionin si më poshtë:

Vitet	Nr. i të punësuarëve
2016	4,492
2017	4,643
2018	4,693
2019	4,738
2020	5,053

2021	5,128
2022	5,242
2023	4,956
2024	4,741
2025	4,472
Total	48,158

Lutemi gjeni bashkëlidhur Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev 2, (e cila është e publikuar edhe në faqen zyrtare të INSTAT), përmes së cilës mund të përcaktohet lloji i aktivitetit dhe kodi NVE Rev 2, për të cilën jeni të interesuar, në mënyrë të tillë që t'ju vendosim në dispozicion një informacion më të plotë.

Lutemi mbani parasysh se të dhënat e mësipërme janë përpunuar bazuar në klasifikimin e veprimtarive ekonomike sipas NVE Rev.2 dhe mund të mos pasqyrojnë në mënyrë plotësisht të saktë numrin real të punonjësve të medias apo të marrëdhënieve me publikun, për shkak se subjektet e deklarojnë vetë objektin e aktivitetit, për rrjedhojë mund të ushtrojnë më shumë se një veprimtari ekonomike.

16	06.05.2026	Informacion mbi hapat që duhet të ndjekë me qëllim për të përfituar nga rimbursimi 10% i TVSH, pas shitjes së produktit industrial duhan në janar 2026	12.05.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, lutemi gjeni informacion në linkun bashkëlidhur https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1916/pyetje-dhe-pergjigje-kompensimi-i-fermereve-permes-autofatures	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	---------	--------

Shënim:

- (1) Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.
- (2) Data e regjistrimit të kërkesës.
- (3) Përmbledhje e objektit të kërkesës duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- (4) Data e kthimit të përgjigjes.
- (5) Përmbajtja e përgjigjes duke e anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
- (6) Përgjigja jepet E plotë/E kufizuar/E refuzuar/E deleguar
- (7) Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik